



SHOQERIA "LIRENG AUDITING" SH.P.K

Adresa: Rruga "Dibres" Pall.324/1 Tirane

Email: lireng.auditing@gmail.com

Tel/Fax: +355 42 450 952

Mob: 0672079155

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

PER AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE
TE AKTIVITETIT TE KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR
PER PERIUDHEN 01.01.2015-31.12.2015

KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

TIRANE

TE NDERUAR ZOTERINJ!

Ne ekzekutimin e misionit qe na eshte besuar, kemi audituar Pasqyrat Financiare te "Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar "(OJF), te cilat perfshijne pasqyrimin financiar per periudhen 1 Janar-31 Dhjetor 2015 te sintetizuar ne Bilancin Kontabel te dates 31 Dhjetor 2015, pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyren e flukseve te parase, pasqyren e ndryshimeve ne kapital si dhe nje permbledhje te metodave kontabel me te rendesishme dhe shenime te tjera anekse qe shoqerojne keto pasqyra.

Drejtimi i KOKSH-ar eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e pershtatshme e te sinqerte te ketyre Pasqyrave Financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

Kjo pergjegjesi perfshin;hartimin, venien ne zbatim dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave financiare pa anomali materiale te shkaktuara nga mashtrimi ose gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e metodave te pershtatshme kontabel, si dhe kryerjen e cmuarjeve kontabel qe jane te aresyeshme per rrethanat e dhena.

Pergjegjesia e shoqerise tone audituese eshte qe te shprehim nje opinion per keto pasqyra financiare bazuar ne auditimin e kryer. Auditimi i kryer nga ana e jone u be ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te zbatojme kerkesat e etikës dhe te planifikojme e te kryejme auditimin me qellimin, per te marre siguri te arsyeshme nese Pasqyrat Financiare jane pa anomali materiale.

Auditimi perfshiu;

Kryerjen e procedurave per te mare evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve te dhena ne pasqyrat financiare.Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit te audituesit, duke perfshire vleresimin e rreziqeve per anomali materiale ne pasqyrat financiare, qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit.

Ne berjen e ketyre vleresimeve te rrezikut, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem perkates te entitetit ne pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare ne menyre qe te hartoje procedurat e auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat perkatese te entitetit, por jo per qellimin e shprehjes se opinionit per efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit.

Auditimi gjithashtu perfshin vleresimin e pershtatshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe llogjiken e çmuarjeve kontabel te bere nga drejtimi me vecorite specifike te saj, si dhe per vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidenca e auditimit qe kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene bazat e opinionit tone te auditimit.

Sipas opinionit tone, Pasqyrat Financiare te “Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar” japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte te gjendjes financiare per periudhen ushtrimore Janar - Dhjetor 2015, dhe performancen e saj financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

Audituesi

“LIRENG Auditing” Sh.p.k

Neshat MAZE (Ekspert Kontabel i Regjistruar)



Tirane, Mars 2016

PASQYRA E GJENDJES SE FONDEVE TE KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2015	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014
GJENDJA	20,666,032.24	18,125,402.37
SHUMA	20,666,032.24	18,125,402.37

PASQYRA E KRIJIMIT TE FONDEVE TE KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2015	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014
TE ARDHURAT	58,165,714.21	32,700,083.16
Te ardhurat nga Komiteti Olimpik Nderkombetar e SO	22,829,746.68	13,436,898.93
Te ardhurat nga Komiteti Olimpik European	14,795,437.12	9,928,367.46
Te ardhurat nga buxheti i shtetit	5,499,000.00	4,434,600.00
Te ardhurat nga sponsorizime vendas		1,170,369.85
Te ardhurat nga anetaresimet	93,000.00	20,000.00
Te ardhura te tjera	14,948,530.41	3,709,846.92
SHUMA	58,165,714.21	32,700,083.16

PASQYRA E PERDORIMIT TE FONDEVE TE KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2015	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014
SHPENZIMET		
Bursa Olimpike	5,623,140.77	559,987.20
Asistence Federative dhe Shoqatave	7,673,150.41	4,742,630.40
Mobilje Paisje dhe Mjete te tjera Invetari	1,490,792.59	842,261.27
Shpenzime per akomodim dhe dieta	6,190,035.48	4,029,660.35
Shpenzime transporti	7,958,752.09	3,453,860.60
Shpenzime per materiale	1,886,818.84	1,502,293.77
Shpenzime postare dhe telefonike	818,663.45	918,347.42
Shpenzime karburanti	268,991.00	278,471.00
Shpenzime per energji elektrike	266,671.60	231,195.60
Shpenzime per qira	267,400.00	326,009.55
Shpenzime per mirembajtje	360,664.00	395,974.75
Shpenzime per honorare (përfshirë tatimi)	3,281,234.93	2,886,493.90
Shpenzime per paga, sigurime, tatime	6,076,806.00	5,655,542.00
Shpenzime Publikimi dhe Promovimi	2,110,738.00	572,247.48
Shpenzime te tjera	5,307,279.86	3,187,064.00
SHUMA	49,581,139.02	29,582,039.29

PASQYRA E KTHIMIT TE FONDEVE NE BUXHETIN E SHTETIT

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2015	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014
KTHYER NE BUXHET	832,733.00	577,414.00
SHUMA	832,733.00	577,414.00

PASQYRA E GJENDJES SE FONDEVE TE KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2015	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014
GJENDJA	28,417,874.43	20,666,032.24
SHUMA	28,417,874.43	20,666,032.24

Audituesi

"LIRENG Auditing" Shpk

Neshat MAZE (Ekspert Kontabel i Regjistruar)

